REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

PROJEKT-V E N D I M
Datë ___/ ___/ 2026

ËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPRONËSIM ME OBJEKT "RIKUALIFIKIMI I OTUARIT KRAHU LINDOR I SHËTITORES JOSIF BUDA DHE RRUGICAVE TE QYTETIT "FAHRI BERBERI" DHE "ABDI TOPTANI" NË LAGJEN NR. 1 DHE 2 KAVAJË, ZONA KADASTRALE 8551" DHE MIRATIMIN E DETYRAVE TË KOMISIONIT TË NGRITUR NË ZBATIM TË PROJEKTEVE TË MIRATUARA NGA BASHKIA KAVAJË

ë mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për etëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" i ndryshuar, VKM nr.138 datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik"i ndryshuar VKM nr.89 date 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" , dhe vleresimin paraprak për këto pasuri, Vendimin 6845 datë 17.11.2025 "Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh, Urdhër nr. 274 datë 27.06.2024 "Për ngritjen e Komisionit për kryerjen e procedurave paraprake për shpronësim të pasurive në pronë privatë për interes public, në zbatim të projekteve të miratuara nga Bashkia Kavajë, i ndryshuar me Urdhërin nr. 155 datë 09.06.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, Këshillit Bashkiak i propozohet:

TË VENDOSË

1. Miratimin e fillimit të procedurave për shpronësim me objekt "Rikualifikimi i trotuarit krahu lindor i shëtitores 'Josif Buda' dhe rrugicave të qytetit "Fahri Berberi" dhe "Abdi Toptani" në lagjen nr. 1 dhe 2 Kavajë, Zona Kadastrale 8551
2. Komisioni i shpronësimit ngarkohet për kryerjen e procedurave si më poshtë;

- Të evidentojë dhe identifikojë pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti.
- Të verifikojë dokumentacionin pronësor për çdo subjekt të prekur.
- Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse për hartimin e hartave, planvendosjeve dhe akt-ekspertimeve përkatëse.
- Të përgatisë dosjen tekniko-ligjore për çdo rast shpronësimi, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Të koordinojë procedurën me institucionet përkatëse shtetërore.
- Të ndjekë respektimin e afateve procedurale të përcaktuara në ligj.
- Të informojë subjektet e prekura mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë procedurës së shpronësimit.
- Të paraqesë raport përfundimtar pranë Kryetarit të Bashkisë/Këshillit Bashkiak mbi ecurinë dhe përfundimin e procedurave

vazhdimin e mëtejshëm të proçedurave të shpronësimit ngarkohen Drejtoria e Kadastrës
oane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve
konomike, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit dhe Komisioni i Shpronësimit
Ky Vendim hynë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55, të ligjit nr.139/2015 "Për
Vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, pas konfirmimit nga institucioni i Prefektit te Qarkut
Tiranë.

Drejtoria e Kadastrë Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike
Izmir Proshka

Drejtoria e Burimeve Ekonomike
Albi Lushka

Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit
Dëshira Qato

Drejtoria Ligjore
Helidon Plaku

Sekretare e Keshillit Bashkiak
Meri Biturku

KRYETAR I BASHKISË
FISNIK QOSJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

RELACION

Akt-vendimi "Për miratimin e procedurës për shpronësim me objekt 'Rikualifikimi i trotuarit anu lindor i shëtitores "Josif Buda" dhe rrugicave të qytetit "Fahri Berberi" dhe "Abdi Toptani" e lagjen nr. 1 dhe 2 Kavajë, Zona Kadastrale 8551', dhe miratimi i detyrave të Komisionit të ngritur në zbatim të projekteve të miratuara nga Bashkia Kavajë" paraqitet për miratim në kushtet kur realizimi i këtij investimi publik është i domosdoshëm për përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe garantimin e sigurisë së këmbësorëve në një nga zonat më të frekuentuara të qytetit.

Gjendja aktuale e trotuareve në krahun lindor të shëtitores "Josif Buda" si dhe në rrugicat "Fahri Berberi" dhe "Abdi Toptani" paraqet amortizim të konsiderueshëm, mungesë standardesh teknike dhe pamjaftueshmëri në garantimin e aksesueshmërisë për të gjithë përdoruesit e hapësirës publike, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët. Rikualifikimi i tyre përbën ndërhyrje me interes publik, pasi synon rritjen e sigurisë rrugore, përmirësimin e cilësisë së jetesës, garantimin e qarkullimit të sigurt dhe të organizuar të këmbësorëve, si dhe harmonizimin urban të zonës në përputhje me standardet bashkëkohore të zhvillimit urban.

Në mbështetje të nenit 41, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shpronësimi lejohet vetëm për interes publik dhe kundrejt shpërblimit të drejtë, ndërsa Ligji nr. 8561/1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, përcakton qartë procedurën, dokumentacionin dhe kriteret që duhen respektuar për realizimin e një procedure të ligjshme dhe transparente shpronësimi. Po ashtu, Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, i njeh bashkisë kompetencën për administrimin e infrastrukturës publike, zhvillimin urban dhe realizimin e investimeve që lidhen me rrjetin rrugor dhe hapësirat publike brenda territorit të saj administrativ. Në këtë kuadër, ndërhyrja për rikualifikimin e trotuareve përbën ushtrim të drejtpërdrejtë të funksioneve të bashkisë dhe realizim të një detyrimi institucional për ofrimin e shërbimeve publike cilësore.

Për shkak se zbatimi i projektit prek pasuri private të regjistruara në zonën kadastrale 8551, është e domosdoshme ndjekja e procedurës së shpronësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar vlerësim të drejtë dhe respektim të plotë të të drejtave të subjekteve të prekura.

Në këtë kontekst, përcaktimi i qartë i detyrave të komisionit të ngritur nga Bashkia Kavajë është një domosdoshmëri administrative dhe juridike, pasi siguron ndarje të qartë përgjegjësish, koordinim institucional, dokumentim të rregullt të çdo hapi procedural dhe respektim të afateve ligjore të parashikuara nga ligji për shpronësimet dhe aktet nënligjore përkatëse. Përcaktimi formal i këtyre detyrave shmang paqartësi kompetencash, rrit transparencën e procesit, garanton mbrojtjen e interesit publik dhe minimizon riskun e pavlefshmërisë procedurale apo kontestimeve gjyqësore.

Sa më sipër, miratimi i këtij projekt-vendimi paraqitet si i nevojshëm dhe i argumentuar si në planin juridik, ashtu edhe në atë teknik dhe urbanistik, duke krijuar bazën ligjore dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Kavajë

VENDIM

Nr. _6845_, datë 17.11.2025

PËR
MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR KRYERJE PUNIMESH

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, si dhe nenit 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë, pasi mori në shqyrtim kërkesën e BASHKIA KAVAJE si zhvillues , me numër identifikimi NID/NUIS K52903801C , dorëzuar më datë 13.11.2025, me numër AN131120250019, për lëshimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh për objektin"Rikualifikimi I trotuarit krahu lindor shetitores "Josif Budo"dhe Rrugicave te Qytetit "Fahri Berberi dhe Abdi Toptani", të ndodhur në zonën kadastrale 8552, adresë Lagja nr 1 dhe 2 Kavaje

VENDOSI:

1. MIRATIMIN e deklaratës së mësipërme për kryerje punimesh.
2. Ngarkohen autoritetet përgjegjëse të inspektimit të respektojnë këtë vendim.

KRYETARI I BASHKISË

Fisnik Qosja

Digitally signed by Fisnik Qosja
2025.11.18 15:38:20 +02'00'